



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A Group" Sh.P.K. të datës 14.08.2023 kundër njoftimit kontratë të datës 11.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 04.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në Lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A Group" Sh.P.K. e datës 14.08.2023 kundër njoftimit kontratë të datës 11.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 04.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në Lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të bëjë ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit lidhur me kërkesat nr. 2 për kapacitetin teknik dhe/ose profesional (9.1 & 9.2) në kuadër të aktivitetit të prokurimit nga pika I e këtij vendimi në përputhje me nenin 7 të LPP.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "2A Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "2A Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit kontratë të datës 11.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 04.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në Lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visur.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Ne si Operator Ekonomik me datë 11.07.2023 kemi pranuar njoftimin për kontratë të emërtuar me titull "Ndërtimi I shkollës në lagjen Kalabria me nr.Prokurimit 616-23-6340-5-1-1, ku është kërkuar tek KUSHTET PËR PJESËMARRJE, më konkretisht tek Kapaciteti Teknik dhe profesional kerkesa 2. Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme : · Një (1) ekspert për testimin e gypave sipas EN 805/W400 si dhe i certifikuar për Menaxhim të punishtës · Nje (1) Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr se paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme. Të jetë i certifikuar sipas OHSAS 18001 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë Në kërkesën për sqarimin të dt .07.08.2023, ne nuk kemi pranuar sqarime rreth këtyre kërkesave, andaj konsiderojmë se këto kërkesa duhet marrë në rishqyrim sepse janë kërkesa tendencioze që kufizojnë apo eliminojnë konkurrencën. Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se): Paragrafi 6 Pika 6.1 kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore;; Konsiderojmë se këto kërkesa janë të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit dhe në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik përkatsisht neni 69, ngase është kriter tendencioz që eksperti për testim të gypave të jetë i certifikuar për menaxhim të punishtës- vet termi nënkuptohet se këto certifikate duhet ta ketë udhëheqësi i punishtës, dhe inxhinieri i hidroteknikes të jetë i certifikuar me ISO OHSAS 18001, pse të jetë i kufizuar pikërisht ky inxhinier, mund të kërkojë të jetë njëri nga inxhinieret e certifikuar por jo pikërisht inxhinieri i hidroteknikes".

Për shkak të këtyre pretendimeve të cituara si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 69 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, kërkesat e dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional me nr. 2 janë përcaktuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: - Një (1) Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr se paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme. Të jetë i certifikuar sipas OHSAS 18001 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> CV-a, Diploma, Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt të jetë e nënshkruar në prani të noterit. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtës dhe për Inxhinieret e dip.
		- Një (1) ekspert për testimin e gypave sipas EN 805/W400 si dhe i certifikuar për Menaxhim të punishtës	Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt

Përmes kërkesës së tij për rishqyrtim parashtruesi ka kërkuar që të ndryshohen/plotësohet kërkesat e dosjes së tenderit të cituara në tabelën si më sipër. Kjo me arsyetimin se kërkesa që eksperti për testimin e gypave të jetë i çertifikuar për menaxhimin e punishtes si e tillë është diskriminuese/favorizuese pasi që këtë çertifikatë duhet t'a dëshmoj udhëheqësi i punishtes dhe jo eksperti për testimin e gypave. Ngjashëm edhe kërkesa që inxhinieri i hidroteknikes të jetë i çertifikuar me OHSAS 18001 si e tillë është diskriminuese/favorizuese pasi që këtë çertifikata mund ta dëshmojë edhe ndonjë nga inxhinierët e tjerë.

Argumentet e parashtruesit bëjnë që pretendimet ankimore të jenë vetëm pjesërisht të bazuara për faktin se përmes dosjes së tenderit nuk është kërkuar asnjë personel me pozitën sikurse e citon parashtruesi "udhëheqës i punishtes". Në anën tjetër nuk do të përbënte shkelje të dosjes së tenderit nëse edhe inxhinierët e tjerë do të ishin të çertifikuar me çertifikatën përkatëse që kërkohet për inxhinierin e hidroteknikës. Pavarësisht kësaj Autoriteti Kontraktues duhet të shqyrtoj mundësinë që të riformuloj dy kërkesat në fjalë të dosjes së tenderit ashtu që sigurohet se është shfrytëzuar çdo mundësi për rritjen e konkurrencës pa cenuar parimin për efikasitet dhe ekonomikitet sipas nenit 6 të LPP si dhe në përputhje me parimet për mos diskriminim/favorizim sipas nenit 7 të LPP.

Vlen të theksohet që përmes nenit 10 paragrafit 10.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se njësia e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të "Përgatit/propozon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Paralogarinë". Në rastin konkret njësia kërkuese ka përgjegjësinë e plotë për kërkesat sipas dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit.

Tutje përmes nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit "në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet".

Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues duhet të rishqyrtoj pretendimet ankimore si dhe të veproj në përputhje me nenin 27 lidhur me nenin 7 të LPP si dhe lidhur me nenin 10 paragrafin 10.1 nënparagrafin b) lidhur me nenin 11 paragrafin 11.3 nënparagrafin b) të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.08.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.